



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Datë: 30.08.2022

Me rastin e mbajtjes së dëgjimit publik lidhur me buxhetin mbahet ky:

PROCESVERBAL:

Të pranishëm në dëgjim ishin: Nënkrjetari i Komunës së Junikut, z. Besart Tofaj, Zyrtari Kryesor Financiar, z. Arten Hamza, Drejtor të drejtorive dhe qytetarë të Komunës së Junikut.

Këtë takim e nisi z. Arten Hamza, Zyrtari Kryesor Financiar, jemi këtu në dëgjimin e parë publik rreth qarkores së dytë buxhetore të lëshuar nga Ministria e Financave si dhe theksoj se jemi në fazën perfundimtare të planifikimit të buxhetit duke treguar dhe afatin e fundit për dorzimin e KAB-it komunal në Kuvendin Komunal si dhe në Ministrinë e Financave, dhe për ta finalizuar këtë Kornizë kërkoj nga qytetarët që të paraqesin qendrimet dhe prioritete tyre. Gjithashtu theksoj se me qarkoren e dytë buxhetore 2023/02 ne i kemi të qartë kufijt final në bazë të kategorive shpenzuese, pra në Paga dhe Meditje, Mallra dhe Shërbime, Shpenzime Komunale, Subvencione dhe Transfere si dhe në kategorine e Shpenzimeve Kapitale, për dallim nga qarkorja e parë buxhetore 2023/01 që i kishim vetëm kufijt nga burimet e financimit.

z. Arten Hamza, Zyrtar Kryesor Financiar, parqiti informaten rreth qarkores së dytë 2023/02 në bazë të kategorive shpenzuese. Ku theksoj që sipas Qarkorës Buxhetore 2023/02, të lëshuar nga Ministria e Financave, ku sipas këtyre kufijve final kategoria e Pagave dhe Meditjeve është në vlerë 1,170,906.00€, kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve 236,740.00€, kategoria e Shpenzimeve Komunale 37,700.00€, kategoria e Subvencioneve 52,000.00€ dhe kategoria e Shpenzimeve Kapitale 380,000.00€.

Më pas, Zyrtari Kryesor Financiar, para se të kaloj fjalën tek qytetarët kërkoj nga ata të cilët kanë ndonjë propozim, ide apo dhe kërkesë dhe nuk dëshirojnë t'a marrin fjalën ti prezantojnë ato në formularët e shpërndarë.

Në vazhdim të takimit pati dhe diskutime me qytetarët, ku disa prej tyre prezantuan dhe i diskutuan kërkesat dhe nevojat e tyre si qytetarë të komunës së Junikut, e disa të tjerë i paraqiten idetë e tyre në formularët e shpërndarë për qëllim të mbledhjes së ideve për Projekte kapitale.

Nga ky dëgjim kemi nxjerr dhe listen me propozimet kapitale të dhëna nga qytetarët e Junikut, këto propozime janë:

1. Ndërtimi i murit mbrojtës në lagjen Tofaj
2. Ndërtimi i rrjetit elektrik në lagjen Kallavaj-Tofaj
3. Ndërtimi i shtëpisë së të moshuarve (pleqve)
4. Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në lagjen Agim Ramdani (pjesa e mbetur)
5. Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në lagjen Bramatok- nga ura e Travës deri tek restaurant Toni
6. Rregullimi i hapsirës publike përballë Stacionit të autobusëve
7. Ndërtimi i pishinave rekreative në Moronicë- Ereniik
8. Vendosja e shtyllave elektrike dhe ndriçimi publik në Lagjen Bramatok
9. Ndërtimi i shtigjeve për këmbësor rreth rrugëve
10. Rruga malore- Qafa e Jasiqit deri në Fireza
11. Pastrimi dhe shërimi i pyjeve me gështenja -Junik
12. Rregullimi i tretoareve në lagjen Berishë
13. Trajtimi i ujërave të zeza
14. Trajtimi i mbeturinave
15. Kanalet e ujitjes
16. Sigurimi i ujit të pijshëm për të gjithë qytetarët e Junikut.

Më pas, duke i falënderuar dhe duke u kërkuar që të marrin pjesë dhe në dëgjimet tjera Zyrtari Kryesor Financiar e shpalli të mbyllur dëgjimin e parë publik mbi qarkoren e dytë buxhetore 2023/02.

E përgatiti
Drejtorja për Buxhet dhe Financa

